FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

OTOL

Pika për vesh, tretësirë
(30 mg + 20 mg + 50 mg) / ml
(Prokainë klorhidrat, Fenol, Fenazon)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Otol dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Otol
3. Si ta përdorni Otol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Otol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË OTOL DHE PËRSE PËRDORET

Otol në përbërjen e tij ka tre lëndë vepruese që janë si më poshtë:

- prokainë (novokainë) klorhidrat, e cila ushtron veprim anestezik lokal;
- fenol, i cili ka veprim dezinfektues kundër formave vegjetative të baktereve gram - pozitive e gram - negative dhe kundër shumë viruseve;
- fenazon, që ushtron veti analgjezike lokale dhe adstringjente e hemostatike.

Otol përdoret në otitet e mesme kongjestive akute dhe katarrale.
Ai përdoret edhe si antiseptik dhe analgjezik në otalgji.
Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Otol.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI OTOL

Mos përdorni Otol në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri të njohur ndaj lëndëve vepruese (prokainë klorhidrat, fenol dhe fenazon) që e përbëjnë barin ose ndaj përbërësit joaktiv të barit siç është glicerina;
- keni perforacione të timpanit në otitin e mesëm kronik dhe në otitin e mesëm me komplikacione.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos e përdorni barin, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Otol
Kur shfaqen efekte anësore ndaj barit, duhet të ndërpritet mjekimi.
Në këto raste, kur ndërpritet bari, duhet të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë.
Rreth ndërveprimit të Otol me barna të tjera nuk ka të dhëna që duhet të merren në konsideratë.

Marrja e Otol me ushqim dhe pije
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme.

Shtatzënia
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë.
Otol mund të jepet gjatë shtatzënisë në qoftë se mjeku e parashikon si shumë të nevojshme.

Ushqimi me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri.
Nuk dihet akoma nëse përbërësit e Otol, si ato aktivë dhe ai joaktiv kalojnë në qumështin e gjirit.
Duke qenë se shumica e barnave kalon në qumështin e gjirit, duhet treguar kujdes gjatë përdorimit të Otol nga nënat që i japin foshnjes gji.
Duhet gjithmonë që para përdorimit të Otol të këshilloheni me mjekun tuaj.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna.

3. SI TA PËRDORNI OTOL

Otol është një bar me pika për vesh që disponohet në flakon 5 ml.
Otol përdoret si më poshtë:
Në otit akut
Otol hidhet me pika përgjatë mureve të kanalit të veshit derisa mbushet (nuk duhet që maja e pikatores të takojë veshin).
Në veshin e sëmurë hidhen disa pika të përgatesës dhe veshit i vendoset një tampon pambuku i lagur me Otol. Pikat e tjera shtohen pas 1 - 2 orësh derisa dhimbja të pushojë e pastaj pikimi rrallohet në një interval prej disa orësh.
Fëmijëve më të vegjël se 6 muajsh u hidhen 2 pika, çdo 2 orë në veshin e sëmurë.

Heqja e dyllit të veshit
Në vesh hidhet Otol me pika, 3 herë në ditë, për 2 ose 3 ditë që të ndihmojë shkëputjen e dyllit nga muret e kanalit të veshit dhe heqjen e tij me lehtësi.
Pas heqjes së dyllit, Otol përdoret edhe për tharjen e kanalit të veshit ose lehtësimin e shqetësimeve.
Përpara dhe pas heqjes së dyllit, një tampon pambuku i lagur me Otol duhet të vendoset brenda veshit.
Gjithmonë përdorini pikat për vesh të Otol vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e tij janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Mjeku juaj mund t´ju kërkojë të përdorni Otol për një kohë më të gjatë. Këshillohuni me mjekun tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt për sa kohë duhet ta përdorni Otol.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Otol
Në qoftë se keni përdorur më shumë Otol se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të përdorni Otol
Në qoftë se harroni një dozë, përdorni dozën në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Një efekt anësor që njihet është mbindjeshmëria e pacientëve ndaj përbërësve të Otol, qofshin ato aktivë ose joaktivë.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI OTOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Otol pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim (etiketë ose kuti).
Mos e ruani mbi 25°C!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Otol
Lëndët vepruese janë: prokainë klorhidrat, fenol, fenazon.
1 ml tretësirë përmban 30 mg prokainë klorhidrat, 20 mg fenol, 50 mg fenazon.
Përbërësi tjetër është glicerina.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 1 shishe me pikatore 5 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes. Pika për vesh.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.